

ARDIAN MUHAJ

**ROLI DHE PRANIA E LUFTËTARËVE SHQIPTARË
NË EUROPËN VERIORE NË SHEK. XVI**

“The King will keep no strangers save the Albanos”¹

Dëshmitë për praninë dhe rolin e shqiptarëve në vendet e Europës Veriore, veçanërisht në Vendet e Ulëta dhe Angli i hasim që në shekujt XIV dhe XV, kur shqiptarët dalin si detarë e rremtarë anijesh, kryesisht veneciane. Këto dëshmi edhe pse të pakta në numër janë të rëndësishme sepse hedhin dritë mbi aspekte pak të njohura ose të panjohura të historisë sonë në këtë periudhë. Në shek. XVI, prania e shqiptarëve në Europën Veriore do të vazhdojë të jetë e ndjeshme, por tashmë jo si detarë e punëtorë anijesh, por kryesisht si luftëtarë, apo stratiotë². Megjithëse stratiotët përmenden që nga fillimi i shek. XV në zotërimet venedikase në Greqi,³ angazhimi i tyre në Itali nis që në fundin e viteve 70 të shek. XV⁴.

¹“Mbreti [Henry VIII i Anglisë] nuk do të mbajë më asnjë të huaj përveç shqiptarëve”. Pjesë e një letre të Lordit Paget në të cilën raporton mbi vendimet e Këshillit të Shtetit anglez ku kërkohet shprehimisht që të lirohen nga detyra të gjitha trupat e huaja në shërbimin anglez përveç shqiptarëve. Kale, 17 dhjetor 1545. *Letters and Papers, Foreign and Domestic, Henry VIII*, volume 20, part 2: August-December 1545, London: His Majesty's Stationery Office, 1907, no. 977, f. 488-504.

² Sophia Antoniadis. “L’Institut grec de Venise, ses buts et son programme, la communauté dont il a hérité, ses trésors d’art et de documents”, *Comptes rendus des séances de l’Académie des Inscriptions et Belles-Lettres*, 104^e année, no. 1, 1960, f. 131. Termi grek *stratōtis/-ai* (στρατιώτης/-αι) përdorej që nga antikiteti, por edhe nga italishtja *strada* (rrugë), në kuptimin e rrugëtarit apo të luftëtarit aventurier. Në Venecia quheshin edhe *capelletti*, për shkak të kësulave të vogla që mbanin. Në lidhje me formën e këtyre kësulave përshkrimet e autorëve përkujtojnë në atë që këto ishin shumë të ngjashme me kësulat e Labërisë shqiptare. Bëhet fjalë për kësulë në formë konike, me një zgjatje të vogël: “capelli aguzzi”. Paolo Petta, *Stratoti: soldati albanesi in Italia, sec. XV-XIX*, Lecce: Argo, 1996, f. 47.

³ Dokumenti i parë venedikas në të cilin del termi *stratitot* i përket vitit 1414. P. Petta, *Stratoti: soldati albanesi ...*, f. 41.

⁴ Elisabeth Crouzet-Pavan, *Triumphant Venice. The Horizons of a Myth*, Baltimore and London: The John Hopkins University Press, 2002, f. 88.

Në literaturën historiografike stratiotët cilësohen rëndom si mercenarë. Mendojmë se një cilësim i tillë është më tepër një pasqyrim i mentalitetit të shek. XX se sa i realitetit të shekullit të stratiotëve. Në fakt më e drejtë do të ishte të quheshin ushtarakë profesionistë, ashtu si çdo trupë ushtarake e specializuar përgjatë historisë. Mund të thuhet se shekulli i artë i pranisë dhe rëndësisë së stratiotëve ashtu si edhe kulmi i shtrirjes gjeografike të rolit të tyre ishte shek. XVI. Duke filluar nga shek. XVII ata bëhen gjithnjë e më pak të nevojshëm dhe për rrjedhojë dokumentohen gjithnjë e më pak. Kjo rënie e rëndësisë së stratiotëve në skenën ushtarake të Europës mund të ketë lidhje si me ndryshimin në mënyrën e luftimit me daljen e armëve të zjarrit, ashtu edhe me integrimin e tyre gjithnjë e më të madh në shoqëri dhe me kalimin e tyre në angazhime dhe role ushtarake më të rëndësishme, të paguara më mirë dhe më pak të rrezikshme.⁵ Angazhimi i tyre ishte i rëndësishëm jo vetëm gjatë konflikteve në raste betejash, por edhe si paqeruajtës në kohë paqeje.

Pavarësisht prej faktit se në shek. XVI luftëtarët shqiptarë, i gjejmë deri në skajet më të largëta të Europës, nga Italia e afërt e deri në Spanjë, në Skocinë e largët, porta e hyrjes së tyre në Europë ishte padyshim përmes Italisë, veçanërisht Venedikut dhe zotërimeve spanjolle të Jugut të Italisë. Ata në mënyrë të kufizuar veçanërisht deri në kalimin e Durrësit nga pushtimi venedikas në atë osman dërgoheshin nga Venediku edhe në tokat shqiptare për të luftuar kundër osmanëve⁶.

Megjithatë stratiotët nuk ishin të vetmet trupa ushtarake profesionale në Italinë e shek. XVI. Në Venedik ata përballëshin me rivalitetin e luftëtarëve gjermanikë, ndërsa në jugun italian kishin si konkurrentë në profesion kalorësinë e lehtë spanjolle, të quajtur *jinetas*⁷. Megjithatë spanjollët që nga fundi i shek. XV fillojnë rekrutimin e trupave stratiotë përkrah atyre të kalorësisë iberike. Në Kalabri Gonzalo Fernández de

⁵ “Un operaio dell’arsenale di Venezia, o un muratore, guadagnavano più di uno stratioto.” P. Petta, *Stratioti: soldati albanesi ...*, f. 61.

⁶ Më 22 shtator të vitit 1480, Senati vendos “një pension për familjen e të ndjerit Dhimitër Bokali, që ishte një prej krerëve të stratiotëve të dërguar në Durrës bashkë me 300 stratiotë për të ndihmuar Krujën. *Dokumenta të shek. XV për historinë e Shqipërisë*, përgatitur nga Injac Zamputi, vëll.4/1, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1967, nr. 61.

⁷ Sipas Lane në Venecia dy trupat kryesore profesionale të huaja ishin shqiptarët dhe gjermanët. Frederic C. Lane, *Venice: A Maritime Republic*, Baltimore and London: The John Hopkins University Press, 1973, f. 392.

Córdoba ("El Gran Capitan") kishte edhe dyqind stratiotë në mesin e forcave të tij ushtarake.⁸ Stratiotët shqiptarë dhe hinetët spanjollë luftuan përkrah njëri-tjetrit përgjatë gjithë shek. XVI. Madje që në betejën e Fornovos më 1495, në të cilën si stratiotët ashtu edhe hinetët spanjollë luajtën një rol me rëndësi në thyerjen e kalorësisë së rëndë franceze.⁹

Megjithë trupat e ndryshme ushtarake profesionale që përfaqësonin tradita të ndryshme të organizimit dhe konceptimit ushtarak, stratiotët u bënë të njohur në historinë e Europës së shek. XVI kryesisht si kalorësi e lehtë, në mesin e trupave të tjera bashkëkohëse. Kështu kontingjenti i mercenarëve europianë përfshinte, jo vetëm stratiotët shqiptarë, por edhe luftëtarë profesionistë francezë, spanjollë, gjermanë, italianë, që të gjithë me karakteristikat e tyre dalluese.¹⁰ Si kalorësi e lehtë, stratiotët, ngjashëm me jinetët spanjollë dhe akinxhijtë osmanë, ishin zakonisht të armatosur thjesht me një ushtë e shpatë dhe më vonë edhe me ndonjë armë zjarri. Kjo i bënte ata të lëviznin më shpejt dhe të depërtonin më me lehtësi në thellësi të territorit kundërshtar se sa kalorësia e rëndë¹¹. Në njëfarë mënyre këto taktika luftimi ngjasonin me mënyrën e luftimit të spahinjve dhe akinxhinjve osmanë. Stratiotëve u vishej zakoni se nuk bënin robër por u prisnin kokat armiqve të vrarë apo të zënë rob dhe paguheshin një dukat për kokë¹².

⁸ "dozientos estratiotes Griegos, muy escogida gente de cauallo". Jerónimo Zurita, *Historia del Rey Don Hernando el Catolico: De las empresas y ligas de Italia*, libroquinto, Zaragoza: por los Herederos de Pedro Lanaja y Lamarca, 1670, f. 243.

⁹ Shih p.sh. P. Petta, *Stratioti: soldati albanesi ...*, f. 107; Javier Irigoyen-García, "The Game of Canes from *Lusus Troiae* to the Albanian *Stratioti*: Defining Moorish and Classical in the Early Modern Spanish Mediterranean", in *Mediterranean Identities in the Premodern Era: Entrepôts, Islands, Empires*, ed. John Watkins, Kathryn L Reyerson, Farnham: Ashgate, 2014, f. 242.

¹⁰ "Frenchdemi-lances, mounted Spanish infantry, and Albanian light cavalry were used in the English borderlands". Michael Mallett, *Mercenaries and their Masters*, London: Bodley Head, 1974, f. 152.

¹¹ Megjithë efektshmërinë e tyre ata nuk shquheshin për disiplinë ushtarake. Të armatosur lehtë stratiotët preferonin të krahmerrnin kundërshtarin duke u vërsulur drejt prapavijës për të shkaktuar konfuzion në rreshtat e parë. M. Mallett, *Mercenaries and their Masters ...*, f. 153.

¹² Philippe de Commines, *Lettres et Negotiations*, with comments by Kervyn De Lettenhove, 1868, Bruxelles: vol. 2, f. 220: "recevaient in ducat par tete d' ennemi qu'ils rapportaient a leurs chefs". Të njëjtën gjë e pohon edhe Marino Sanuto kur thotë se ata janë besnikë ndaj drejtuesve të tyre, nuk mbajnë robër, por u heqin kokat kundërshtarëve, duke marrë sipas zakonit të tyre një dukat për kokë. Marino Sanuto,

Debutimi dhe fama ndërkombëtare e stratiotëve i dedikohet një pjesë të mirë suksesit të tyre në betejën e Fornovos¹³, ku padyshim Mërkur Bua, më i famshmi i stratiotëve të të gjitha kohërave, pati peshën kryesore në këtë debutim. Ai u shqua dhe fitoi grada e tituj jo vetëm nga venedikasit por edhe nga francezët dhe habsburgët duke mbetur si heroi dhe figura më e njohur e historisë treshekullore të stratiotëve.¹⁴ Veç kësaj, ishte Bua një nga të paktët komandantë të shquar stratiotë që vdiq nga pleqëria dhe jo nga rreziku i profesionit¹⁵. Gjithashtu, Merkur Bua ishte ndër të parët që veprimtarinë e tij e shtriu deri në Europën Veriore. Në vitin 1508, ai luftoi në Flandër të Belgjikës, kundër trupave të dukës Gheldria.

Të impresionuar nga taktikat improvizuese të stratiotëve fuqi të tjera europiane zunë shpejt të kërkonin ndihmën e tyre. Mbreti Louis XII i Francës rekrutoi rreth dy mijë stratiotë që më 1497, vetëm dy vjet pas betejës së Fornovo-s. Edhe mbreti Charles IX vazhdoi t'i rekrutonte dhe madje shquhen në betejën e Dreux më 1562.

Në Angli përdorimi i trupave të tilla të kalorësisë së lehtë u bë praktikë e zakonshme në shek. XVI duke u shndërruar në një forcë të domosdoshme veçanërisht për mbrojtjen e zonave kufitare me Skocinë dhe në luftërat anglo-franceze në Francën Veriore dhe Vendet e Ulëta.¹⁶ Monarkët tudorë të Anglisë në traditën e Luftës Njëqindvjeçare vazhduan të kenë pretendime dhe të dërgojnë ushtri në kontinent, kryesisht në Francë gjatë gjithë gjysmës së parë të shek. XVI.¹⁷ Ushtritë e Henrit VIII pushtuan pjesë të territorit francez tri herë gjatë kësaj periudhe, më 1513, 1523, dhe 1544. Tournai u pushtua më 1513 ndërsa Boulogne më 1544

La spedizione di Carlo VIII in Italia, per cura di Rinaldo Fulin, Venezia, 1883, f. 313; Marino Sanuto, *Commentarii della guerra di Ferrara*, Venezia: 1829, f. 115.

¹³ Kenneth M. Setton, *The Papacy and the Levant (1204-1571): The Thirteenth and Fourteenth Centuries*, volume 1, American Philosophical Society, 1976, f. 494.

¹⁴ Constantinos Sathas, *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au Moyen Age*, Paris: J. Maisonneuve, 1890, tome 9, f. xiv-xxviii; P. Petta, *Stratioti: soldati albanesi ...*, f. 93-95.

¹⁵ Ishte me origjinë nga Nafplio apo Napoli di Romania dhe vdiq në vitin 1542 në rezidencën e tij në Treviso. Megjithëkëtë ai e identifikonte veten si shqiptar. Pëllumb Xhufi, "Kombi shqiptar: një vështrim nga mesjeta", në *Studime historike*, 3-4, Tiranë: 2013, f. 8.

¹⁶ Robin D. S. Higham, *A Guide to the Sources of British Military History*, Routledge & Kegan Paul, Great Britain: 1972, f. 171.

¹⁷ Gilbert John Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries 1485-1547*, Charlottesville: University Press of Virginia, 1980, f. 3.

edhe pse nuk u mbajtën për më shumë se një dekadë secila.¹⁸ Pjesëmarrjen e stratiotëve në betejën e Spurs-it më 1513 e përshkruan kronisti Edward Hall¹⁹. Kontingjente të kufizuara stratiotësh u angazhuan nga mbreti i Anglisë Henry VIII (1509-1547), që më 1514, në betejat me Mbretërinë e Skocisë.²⁰ Në modelin e kalorësive të lehta në kontinent u formësua kalorësia e lehtë anglo-skoceze e quajtur Kalorësia e Veriut ose e Kufirit që u bë e njohur për efektshmërinë e saj në sulme të befasishme dhe prita²¹. Megjithatë veprimtaria e Kalorësisë së Veriut, siç e pasqyron edhe emërtimi i tyre, kufizohej në mbrojtjen e kufirit verior me mbretërinë e Skocisë.

Rekrutimi i trupave ushtarake profesionale të huaja gjatë mbretërimit të Henri VIII merr përmasa masive si asnjëherë më parë, duke rekrutuar me mijëra, fillimisht në fushatat e tij në Francë, sidomos gjatë mbrojtjes së Boulognes dhe duke filluar nga viti 1544 edhe në luftën kufitare me Skocinë, duke arritur deri mijëra trupa. Kalorësia e rëndë rekrutohej kryesisht nga Gjermania dhe Holanda, ndërsa kalorësia e lehtë fillimisht e rekrutuar nga po këto zona, shkoi duke e zgjeruar prejardhjen gjeografike duke përfshirë kontingjente italiane e spanjolle si edhe stratiotë shqiptarë e grekë²².

Në këtë periudhë përdorimi i trupave të huaja në Europë ishte bërë një praktikë aq e zakonshme sa që për shembull në vitin 1542 Franca

¹⁸ 28 nëntor 1522. [Cotton to Paget]. "The French army is at Montereul. It is not large, but much spread out... The number of the French army is not 800 men; and the Albanos, though they pretend to be 500 horse, are not more than 300, and badly mounted". *British Museum, Caligula, D. VI, 351; Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, volume 3: 1519-1523 (1867), f. 1135-1155; "Vendôme, however, is to remain governor of Picardy "et y ... cinq ou six cens Albanos a cheval". *British Museum, Caligula, D. IX. 126; Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, volume 4: 1524-1530 (1875), f. 595-610.

¹⁹ Edward Hall, *Chronicle; containing the history of England, during the reign of Henry the Fourth, and the succeeding monarchs, to the end of the reign of Henry the Eighth, in which are particularly described the manners and customs of those periods. Carefully collated with the editions of 1548 and 1550*, London: Printed for J. Johnson, 1809, f. 543, 550.

²⁰ R. Higham, *A Guide to the Sources of British Military History...*, f. 171.

²¹ Jeffrey Marcus Becker, *Armed conflict and border society: The East and Middle Marches, 1536-60*. Durham theses, Durham University: 2006, f. 30.

²² Millar i quan: "The famous "Albanoyes horsemen". G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, f. 43-45; Paul E. J. Hammer, *Elizabeth's Wars: War, Government, and Society in Tudor England, 1544-1604*, Palgrave Macmillan, 2003, f. 24.

kishte rreth 70 mijë trupa të tillë të angazhuara kundër spanjollëve në Itali e Vendet e Ulta përveç trupave franceze, ku natyrisht nuk do të mungonin as stratiotët shqiptarë, edhe pse në numër të vogël krahasuar me kontingjentet e tjera²³.

Megjithëse rekrutimi i trupave të huaja nga anglezët në kontinent nis që më 1513, përdorimi i tyre brenda Anglisë filloi rreth vitit 1545. Në këtë kohë Anglia si aleate e spanjollëve dërgoi një trupë për të mbrojtur zotërimet spanjolle në Vendet e Ulëta që kërcënoheshin nga francezët. Komanda e fushatës iu besua Sër John Wallop, i cili me 5 mijë trupa u nis nga Kalais në korrik. Grumbullimi dhe zhvendosja e trupave franceze në Hainaut, zonë strategjike për mbrojtjen e vetë Brukselit bëri që Wallop nën urdhrat e Marisë së Hungarisë të angazhohet në sulmin e fortesës së Landrecies në Hainautin jugor.

Nga pikëpamja strategjike ajo shihej si një pikë kyçe e krejt zonës dhe si hyrje drejt Artois dhe madje drejt vetë Brukselit. Kështu, aty u dërguan forca angleze dhe trupa të huaja ndihmëse. Për rreth 4 muaj që zgjati rrethimi fortesa nuk u arrit të merrej.²⁴ Nga fundi i tetorit rrethimi u hoq dhe forcat e Wallop u urdhëruan të ktheheshin në garnizon për të dimëruar dhe në fillim të nëntorit forcat angleze morën leje për t'u kthyer në Kalais.

Mirëpo, meqë komandanti anglez kishte fituar reputacion si njohës i mirë i trupave në konflikt, iu kërkua që përpara se të kthehej, të hartonte një listë nga mes i qindra komandantëve të huaj me të cilët ai kishte bashkëluftuar e bashkëvepruar përditë, që në rast se mbreti anglez Henri VIII, do të vendoste për të kaluar La Manshin dhe për të sulmuar Francën do të kishin dëshirë të bashkoheshin. Wallop nisi të mbajë shënime dhe pastaj informoi Sër William Paget, ambasador anglez në Paris dhe një nga dy sekretarët kryesorë të mbretit, se ai njihte rreth 40 a 50 shqiptarë të cilët mund të ftoheshin për të forcuar radhët e skuadrës së Kalorësisë së Veriut të stacionuar në Guines. Megjithëse jo të gjithë iu përgjigjën ofertave angleze, Henri VIII ia arriti të grumbullojë një numër të konsiderueshëm luftëtarësh.

²³ Në vitin 1542, nga 70 mijë vetë të shpërndarë në disa fronte si në Itali dhe Roussillon, 43 mijë ishin zviceranë dhe gjermanë; 4-5 mijë italianë, dhe dy mijë veta kalorësi e lehtë, kryesisht *jineta* baskë dhe stratiotë shqiptarë. *Calendar of State Papers ... Spain*, vol. 6, part. 2, no.23; *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 17, nos. 517, 528, 554.

²⁴ G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries...*, f. 71-72.

Grumbullimi i tyre vazhdoi gjatë fillimit të 1545-ës deri sa nga Kalais, sekretari Paget njoftonte nga fundi i shkurtit se ishin grumbulluar aq shumë mercenarë sa që kishin filluar të bëheshin shqetësim serioz për rendin e qetësinë e qytetit.²⁵ Rekrutimi i trupave të huaja kishte vështirësitë dhe peripecitë e veta edhe për fuqitë që i përdornin. Shpeshherë ata shndërroheshin në rrezik për vetë fuqitë që i rekrutonin në rast të moskorrektësisë në pagesë, apo të përfundimit të parakohshëm të kontratave ashtu si edhe në periudha kur qëndronin për një kohë të gjatë pa u angazhuar në luftime²⁶.

Ndërkohë një tjetër kërcënim ndaj anglezëve shfaqej në kufirin verior. Më 27 shkurt, një trupë angleze prej 5 mijë vetash u sulmua në pritë nga skocezët në kufi. Njëmijë e katërqind anglezë u vranë e u zunë rob. Për më tepër anglezët morën vesh se një ushtri franceze prej 6 mijë vetash pritej të mbërrinte në ndihmë të skocezëve në mars, si pararojë e një ushtrie prej 40 mijë vetash që po planifikonte të zbarkonte në bregun verilindor të Anglisë.²⁷ Situata kërcënuese ndaj anglezëve në Skoci bëri që të përshpejtohej dërgimi i trupave nga Franca veriore drejt kufirit me Skocinë. Edhe pse forcat angleze të mobilizuara nga zonat kufitare arritën në rreth 30 mijë veta, Henri VIII e pa të nevojshme përforcimin e tyre me trupa të huaja. Në mesin e këtyre trupave të huaja përveç spanjollëve, gjermanëve e italianëve ishin edhe një numër i caktuar stratiotësh shqiptarë.²⁸ Në total një e dhjeta e ushtrisë angleze përbëhej nga të huajt. Inkuadrimi i tyre në këtë rast lidhej jo vetëm me faktin se ata nevojiteshin në fushatën e Skocisë por edhe sepse ata duhej të mbaheshin të angazhuar në Francë, ku lufta hë për hë kishte pushuar, përndryshe në se qëndronin

²⁵ *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol.20, pt.I, no. 257; pt. 2, no. 704.

²⁶ Letër e Muxetula drejtuar Perandorit Karli V, ku i raporton për situatën në Itali: "The Prince has also, in a very polite way, dismissed many hundreds of Albanese light horse and sent them to Naples, to be paid and disbanded there. He could not do it here, as he was ordered, because had they been dismissed at this place there was a risk of their taking service with the enemy, for they are Greeks and are in the habit of doing this sort of thing... The Prince has kept 250 of them, the best of the lot, and given to those who have left for Naples 1,000 ducats. *British Museum*, Add.28, 580, f. 1; *Calendar of State Papers ...*, Spain, vol. 4 p. 1, (1879), f. 523-543.

²⁷ *Calendar of State Papers ...*, vol. 5, f. 412; G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, f. 132.

²⁸ Italian "hacquebutiers of horseback", and Albanian stratiots, the first companies of which had been enlisted by Gobham in February. *The National Archives* (më tej: TNA), SP I/198, fl. 48; *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 20, pt. I, no. 513.

pa “punë” në fakt përbënin një rrezik për vetë anglezët²⁹. Në fushatën skoceze dhe në mbrojtjen e Boulognes Anglia bëri grumbullimin më të madh ndonjëherë të ushtarëve të huaj³⁰.

Megjithë dislokimin në frontin skocez, anglezët bënë kujdes që të mos linin Boulognen pa mbrojtjen e duhur, prandaj numri i mercenarëve që grumbulloheshin aty vazhdoi të shtohet gjatë gjithë verës. Nga një listë e gushtit të atij viti nga një total prej 6 920 ushtarësh, 737 ishin të huaj, në mesin e të cilëve dalin edhe 102 kalorës shqiptarë që kishin ndërruar shërbimin francez për atë anglez.³¹

Po ashtu në Guines, Hammes, dhe Calais, ushtarë nga të gjitha kombësitë ishin grumbulluar. Mes tyre edhe shqiptari George Moszia nga Napoli dhe italianii Ludovico Morescotto, vinin nga zonat franceze ose nga vendet e ulëta.³² Drejt Guines, në gusht, 200 gjerman dhe 300 spanjollë, u dërguan për t’iu bashkuar një kontingjenti të konsiderueshëm anglezësh, shqiptarësh dhe italianësh.³³

Një kronikë e luftërave të stratiotëve shqiptarë në fushatën e vitit 1545 në Skoci dhe e luftës për mbrojtjen e Boulogne më 1546 u shkrua nga Nikandër Nukis nga Korfuzi i cili shoqëroi në pozicion joushtarak fushatën angleze³⁴. Forcat stratiote në këtë fushatë udhëhiqeshin nga Tomas Bua, apo Toma nga Argosi³⁵. Nukis i shoqëroi Tomas dhe

²⁹ Në Kale gjatë marsit, vrasjet e plagosjet mes trupave të grumbulluara ndodhnin përditë, dhe tregu i qytetit ishte shndërruar në fushëbetejën e preferuar të mercenarëve të kombësive të ndryshme. G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, f. 133.

³⁰ “...there were so many depraved, brutish soldiers from all nations under the sun: Welsh, English, Cornish, Irish, Manx, Scots, Spaniards, Gascons, Portingals, Italians, Arbannoises, Greeks, Turks, Tartars, Almaines, Germans, Burgundians, Flemings, who had come there... to have a good time under the king of England, who by nature was too hospitable to foreigners. Elis Gruffydd, “Boulogne and Calais from 1545 to 1550”, in *Bulletin of the Faculty of Arts*, Fouad I University (Cairo), 12 (1950), f.15.

³¹ *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 20, pt. 2, no. 200.

³² *British Library*, Harleian MS. 283, fols. 246, 231; *Acts of the Privy Council of England*, ed. John Roche Dasent, vol.I, 1542-1547, London: 1890, f. 169.

³³ G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, p.145-146.

³⁴ Andreas Moustoxydes, “Nikandros Noukios”, në gazetën *Pandora*, vol. 7, nr. 154, 15 gusht, 1856, f. 222.

³⁵ *The second book of the travels of Nicander Nucius of Corcyra*, ed. by J.A. Cramer, London: 1841, f. 90.

ushtinë angleze deri në lumin Tweed që ndan Anglinë dhe Skocinë ku kalorësia stratiote kreu inkursione kundër skocezëve.³⁶

Kjo fushatë në jug të Skocisë edhe pse nuk zgjati shumë ishte e përgjakshme. Gjenerali Hertford me forcat e tij angleze e të huaja mbasi kaloi kufirin në fillim të shtatorit përparoi drejt Roxburgh në zonën e Kelso-s. Nga Kelso ushtria angleze vazhdoi marshimin drejt Jedburgh. Në ditët në vazhdim Melrose, Dryburgh, megjithë abacitë e tyre dhe një numër fshatrash më të vogla u dogjën. Nga mesi i shtatorit ndërkohë që Hertfordi ndëshkonte me zjarr e hekur këtë qytet me rrethina, rreth 1500 kalorësi e lehtë mes të cilëve edhe një numër stratiotësh shqiptarë e vazhduan bastisjen edhe më thellë në territorin skocez. Pastaj u kthyen drejt Northumberland, duke djegur e pjekur përmes zonës së Merse deri sa mbërritën në Norham më 23 shtator.³⁷

Ndërkohë në Angli vazhdonin të mbërrinin përforcime trupash të huaja në masë të madhe.³⁸ Emrat e një numri të madh mercenarësh që ndodheshin në Angli dalin në llogaritë financiare të Sër Thomas Chaloner, punonjës i *Privy Council*, i ngarkuar në verën e vitit 1545 si dërgues fondesh për trupat e huaja, që ndodheshin në fushatën e komandantit Hertford në veri në kufi me Skocinë. Gjatë maj-qershorit ai dërgoi fonde e rroga për afërsisht 10 njësi të tilla, shqiptarësh, gjermanë, italianë, dhe spanjollë.³⁹ Të dhënat e regjistruara zbulojnë në një farë mase mënyrën e organizimit të stratiotëve. Në dy skuadrat e shqiptarëve të paguara prej tij për periudhën deri më 30 maj mund të zbulohet zinxhiri i hierarkisë stratiote, ngjashëm me atë që ekzistonte në kompanitë angleze⁴⁰. Tre oficerë përmenden: një kapiten, asistenti i tij, një nënkapiten ose lejtant dhe një ndihmës.⁴¹

³⁶ Gilbert John Millar, "The Albanians: Sixteenth-Century Mercenaries", in *History Today*, 26 (1976), f. 470, 472; G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, f. 44, 48, 69, 73, 133, 146.

³⁷ Hertford mburrej se kishte shkatërruar "no fewer than seven monasteries and over 240 villages and towns". *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 20, pt. 2, no. 456.

³⁸ G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, p. 146-147.

³⁹ *TNA*, E 351/43, mems.4,6.

⁴⁰ *Po aty*, membrane 8.

⁴¹ *Po aty*, membrane 7. Këta oficerë paguheshin respektivisht £15, £7 dhe £6 6s për muaj. Ushtarët e zakonshëm paguheshin jo më shumë se 50 shilinga. Dy kapedanët ishin Theodore Luchisi dhe Antonio Stesino. *TNA*, SP I/198, fol. 48. Të dy vinin nga Kale (Calais), Luchisi me 47 kalorës dhe Stesini me 52. *Po aty*, E 351/43, mem. 4.

Atë dhjetor me fillimin e dimrit forcat angleze e të huaja u vendosën në kazerma, ndërsa një pjesë e tyre së bashku me shqiptarët u deklaruan të lirë për t'u kthyer në shtëpi⁴². Në anën tjetër të La Manshit edhe Boulogne, i kishte mbijetuar sulmit francez.⁴³ Mirëpo, simbas një këshille të Pagetit ishte më e leverdisshme të mbaheshin mercenarët nën rrogë gjatë dimrit se sa të liroheshin dhe pastaj të rekrutoheshin sërish në pranverë⁴⁴. Ndërkohë mercenarë të rinj vinin vazhdimisht edhe gjatë dimrit kudo në zonën e frontit në Calais dhe Boulogne. Madje, në këtë të fundit mbërritën aq shumë shqiptarë sa që u pa e arsyeshme që në krye të tyre të emërohej një komandant shqiptar, si kolonelin e tyre, “Cavalier” Thomaso Bua.⁴⁵

Trupat e komanduara nga Hertdordi mbas “paqëtimit” të skocezëve, rreth 5 apo 6 mijë kaluan La Manshin në fund të marsit. Atje ai u bashkua me pjesën më të madhe të mercenarëve që e kishin shoqëruar në fushatën e Skocisë. Dy komandantë shqiptarë Antonio Stesino dhe Nicholas Cresia mbas fushatës skoceze ishin pranuar në janar secili në krye të 50 kalorësve nën komandën e Buas në Boulogne.⁴⁶ Numri total i forcave nën Hertfordin në Francë mbërriti në 30 mijë mes të cilëve edhe mjaft shqiptarë. Detyra e tyre ishte të ndihmonin Hertfordin në ndërtimin e një fortese të re në Ambleteuse rreth 10 km në veri të Boulognes. Hertford mbërriti në Ambleteuse më 30 mars me 7 mijë veta prej të cilëve 2600

Mbi prejardhjen gjeografike të emërfamiljeve të stratiotëve shih: Giuseppe Valentini, “Sviluppi onomastici-toponomastici tribali delle comunità albanesi di Sicilia”, në F. Giunta, G. Valentini, A. Guzzetta, M. La Piana, M. Mandalà, *Albanesi in Sicilia*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo: A. C. Mirror, 2003, f. 38-56.

⁴² *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol.20, pt. 2, nos. 572, 621; TNA, E 351/43, mem.9.

⁴³ G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries...*, f. 151.

⁴⁴ Letër e Paget drejtuar Këshillit të shtetit. “Now the Council's letters seem to imply [citon fjalë për fjalë] that the King will keep no strangers save the Albanos... Prays God to bring it to pass that we shall need neither Albanos nor our own men until reformed from following the naughty example of strangers in deceiving the King in their musters... I have sent to Sir Richard Southwell to stay the Albanos at Bullen. Kale, dhjetor 1545. *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 20, part 2, (1907), no. 977, f. 488-504.

⁴⁵ Bua përmendet si kolonel që në janar të vitit 1546. *Acts of the Privy Council ...*, I, 318; *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 21, pt. I, no. 301. C. N. Sathas, *Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grece au moyen age ...*, e përmend si Thomasi nga Argosi, dhe udhëheqës i 550 peloponezasve.

⁴⁶ *Acts of the Privy Council ...*, vol.I, nr. 315, 316, 322.

ishin të huaj⁴⁷. Pjesa tjetër e ushtrisë nën Lord William Grey në përbërje të së cilës ishin gjermanë, i cili një ditë në të gdhirë i ndihmuar edhe nga 40 kalorës shqiptarë të skuadrës së Buas i bëri një pritë kalorësisë së Vendôme. Nga ana angleze mbetën të vrarë vetëm dy këmbësorë, afërsisht 40 apo 50 kalorës francezë u zunë rob dhe rreth 100 ushtarë e kalorës u vranë. Henri VIII shprehu ngazëllimin dhe falënderimin për këtë fitore në një letër drejtuar komandantit Hertford më 26 maj. Si pasojë një armëpushim u nënshkrua në Camp, ndërmjet Guines dhe Ardres, më 7 qershor.⁴⁸

Mbas fushatës kundër Skocisë më 1546 edhe Thomasi me stratiotët e tij u dërgua nga Henry VIII në Francën Veriore në betejën e Bulonjës si komandant i një batalioni prej 550 vetash dhe madje u plagos në betejë⁴⁹. Kronisti përshkruan një përballje mes njësisë së Tomasit prej 550 vetash dhe një njësie franceze më të madhe rreth një mijë vetash gjatë rrethimit të Bulonjës. Stratiotët u zunë pritë francezëve që po vinin nga Bulonja në të dalë të dritës dhe me manovrimë të shpejta i bënë të tërhiqen duke lënë 360 francezë të vrarë përkundrejt vetëm 35 stratiotëve të mbetur në betejë.

Megjithatë fati i tij mbas kësaj fushate duket se ishte tragjik, mbasi u kap nga francezët dhe u ekzekutua në Torino më 1546. Si duket roli i tij kundër tyre në Bulonjë ishte i tillë sa që nuk mund t'ia falnin jetën, edhe pse arrestimi i tij ishte bërë mbas mbarimit të luftës dhe nënshkrimit të paqes. Për këtë arsye anglezët u përpoqën të ndalojnë ekzekutimin e tij dhe kur morën vesh se ishte arrestuar dhe ekzekutuar mbas nënshkrimit të armëpushimit kërkuan shpjegime nga francezët për këtë⁵⁰, por francezët sajuan një histori sikur Bua kishte marrë një sasi të hollash nga eprorët e tij, gjë të cilën anglezët e konsiderojnë si të pabesueshme dhe të pabazë.⁵¹

⁴⁷ Bashkë me 1500 spanjollë, 500 anglezë të Veriut dhe 500 italianë nën komandën e Amerigo Antenori, Francesco Agelo, e Francesco Tiberio nga Kalabria ishin edhe 100 stratiotët e Stesinit dhe Cresias. *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol.21, pt.I, nos. 356, 416, 612; *British Library*, Add.MS. 5753, fols.190-91.

⁴⁸ G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries...*, f. 161-162,165.

⁴⁹ A. Moustoxydes, "Nikandros Noukios...", f. 222.

⁵⁰ 4 nëntor 1546. "Selve to Francis I. The King has asked him to write about the arrest, at Turin, of the Cavalier Boa, an Albanese, taken since the signature of the peace". *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol. 21 part 2, (1910), pp. 169-188.

⁵¹ "Captain Bua, the Albanos taken at Turin, was sentenced and executed a fortnight before the date of the letter directing Wotton to speak for him. Is told that he ran away with money of his captain... The Admiral and Cardinal of Tournon assure Wotton

Nënshkrimi i paqes me Francën solli si rrjedhojë zvogëlimin e dukshëm të pranisë ushtarake të huaj.⁵² Në gjysmën e dytë të shek. XVI mbështetja angleze në trupat e huaja ra në mënyrë drastike. Megjithatë, mbështetja e anglezëve në forcat e huaja vazhdoi edhe mbas vdekjes së Henrit VIII, por në përmasa më të vogla.⁵³ Në fushatën kundër Skocisë në shtator 1547, ushtria angleze përfshinte sërish një numër të lartë mercenarësh. Me këtë rast ushtria skoceze u thye keqas në Pinkie Cleugh edhe pse Leith, porti i Edinburgut, u dogj. Por në mbretërimin e Edward VI (1547-1553), trupat e huaja filluan të përdoren për të mbajtur rendin brenda vetë Anglisë. Veçanërisht roli i tyre që i rëndësishëm në shtypjen e dy rebelimeve që vunë në rrezik kurorën angleze më 1459, kur mijëra mercenarë shumica e të cilëve veteranë të fushatave skoceze u përdorën. Emrat e një numri të madh të tyre janë ruajtur në dokumente,⁵⁴ ku dalin veçanërisht shumë italianë, gjermanë, spanjollë dhe shqiptarë në shtypjen e kryengritjes së ashtuquajtur të “Prayer Book”.⁵⁵

Megjithëse me ritme të zvogëluara angazhimi i stratotëve shqiptarë në Vendet e Ulëta vazhdoi gjatë gjithë shekullit. Më 1562 kalorës shqiptarë mbërrijnë në Paris.⁵⁶ Në dimrin e vitit 1577-1578, tetëqind kalorës shqiptarë hynë në Namur të ndjekur nga 8 mijë këmbësorë spanjollë, duke thyer keqas francezët dhe skocezët.⁵⁷ Më 1580, 300 kalorës shqiptarë dokumentohen në Belgjikë, në qytetin e Cambrai-t, të

(which he can hardly believe) that when in the King's service Bua offered to return to the French king”. Chauny, 28 nëntor 1546. *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, vol 21/2, f. 203-248.

⁵² W. K. Jordan, ed., *The Chronicle and Political Papers of King Edward VI*, f. 123-24, 147, 176, 177.

⁵³ W. K. Jordan, *Edward VI: the young King; the protectorship of the Duke of Somerset*, London: Allen & Unwin, 1968, f. 466-467.

⁵⁴ *TNA*, E 351/43, mems.I- 13. Këto dokumente kanë të regjistruar pagesat e bëra ndaj të huajve ndërmjet viteve 1545-1551.

⁵⁵ G. Millar, *Tudor Mercenaries and Auxiliaries ...*, f. 175-176.

⁵⁶ Smith to Cecil. 200 Italian and Albanese horsemen came to Paris from Piedmont, and are going to the Duke of Guise, and his army now numbers 16,000 or 17,000. 26 dhjetor 1562. *Calendar of State Papers ...*, *Foreign, Elizabeth*, fol. 5, f. 594ss.

⁵⁷ “800 Albanese horse for Don John entered Namur, and the next day 8,000 Spaniards, footmen. On Friday, the 31st, about eight o'clock they set upon the Frenchmen and overthrew them, and immediately pursued the Scots”, Antverp, 29 janar 1577. *Calendar of State Papers ...*, *Foreign, Elizabeth*, vol. 12, f. 482.

cilët në një përpjekje me francezët lanë 20 të vranë.⁵⁸ Dy vite më vonë shqiptarët duket se kanë rol kryesor në mbrojtjen e kështjellave dhe lëvdoheshin për aftësitë e tyre luftarake.⁵⁹ Më 1587, Duka i Lorraines rekrutoi 500 kalorës shqiptarë ndërkohë që ndërmjet viteve 1588 dhe 1591 dokumentohen edhe pesë komandantë stratiotë me njësitë përkatëse⁶⁰. Po në këto vite dokumentohet edhe një kalorës që mbante emrin e të famshmit Merkur Bua.⁶¹ Padyshim që angazhimi në kontingjentet stratiote kishte rreziqe të mëdha. Në një dokument të marsit 1589 nga Dieppe mësojmë se 400 kalorës “Albanoy”, ishin thyer në Flandër gjatë rrugës për t’iu bashkuar gjeneralit de Maine.⁶²

Shpesh ecejaket e tyre nëpër Europë i çonin këta kalorës shqiptarë në skajet më të largëta të kontinentit, siç është rasti i komandantit Gjergj Creshi. Në qershor të vitit 1593 nga Kalais njoftohej se kapidan Giergio Creshi që kishte udhëhequr një kompani kalorësish në Belgjikë pasi kishte siguruar lejekalimin nga mbreti francez, kërkonte edhe një të tillë

⁵⁸ Letër e M. de Lapret drejtuar M. de Bonele: “entered the town of Cambray the last day of last month four French companies in full strength and well armed... After dinner the Albanese to the number of 300 horse came and made a pretty skirmish before the town, in which the French and the old garrison behaved valiantly, and but for night coming on, not many of the Albanese would have escaped. They left 20 dead on the ground, and 3 prisoners... Next day the Albanese had their revenge on four French companies of the regiment of M. de Chamois, who were quartered at Prémont [Brunémont] away from the others who were at Bouchain. Tournay, 23 dhjetor 1580. *Calendar of State Papers ..., Foreign, Elizabeth*, vol. 14, f. 520.

⁵⁹ “The soldiers of the garrison of Brussels have also taken the land of Almôt but not yet the castle, which is very strong and well-garrisoned with good Albanese soldiers. They hope, however, that it will soon surrender, some great pieces of artillery being planted to batter it”, Antwerp, 5 janar 1583. *Calendar of State Papers ..., Foreign, Elizabeth*, vol. 17, f. 648.

⁶⁰ N. Bonaparte, *Études sur le passé et l'avenir de l'artillerie*, Paris: 1846, vol. 1, p. 161.

⁶¹ Cobham i shkruan Walsingham: “Captain Mercurio di Bua, Albanese, is appointed by Monsieur to bring a band of Albanese horsemen into France”, 6 janar 1582. *Calendar of State Papers ..., Foreign, Elizabeth*, vol. 15, f. 1ss.

⁶² Ottywell Smyth i shkruan Walsinghamit: “News from the Court that 400 Albanoy horsemen, on their way to join de Maine, have been defeated”, Dyepe, 26 mars 1589. *Calendar of State Papers ..., Foreign, Elizabeth*, vol. 23, (1950), f. 158. Ka të ngjarë që shqiptarët që raportohen në këtë vit, ishin të njëjtët që dalin një vit më parë: Stafford për Walsingham: “M. de Lorraine hath sent in such post haste for his Albanoy and other troops, who this night are to lodge ten leagues beyond Chateau Tyrry”, Paris, 7 korrik 1588; *Calendar of State Papers ..., Foreign, Elizabeth*, vol. 21, part 4, f. 212-221.

nga autoritetet angleze, prandaj i dërgonte një letër Lord Willoughby, ku i kërkonte një lejkalimi për veten dhe disa njerëz të tij për të kaluar përmes detit në Spanjë për të marrë shpërblimet dhe nderimet e duhura nga mbreti i Spanjës, dhe më pas do kalonte nga Spanja në Itali për t'i shërbyer Dukës së Toskanës.⁶³

Kalorësia e lehtë shqiptare si fenomen kulturologjik

Shumë kronistë dhe autorë të njohur, si Coriolano Cippico⁶⁴, Marino Sanuto⁶⁵, Philip de Comines⁶⁶, F. L. Taylor⁶⁷, Konstantinos Sathas⁶⁸, John Hale, e M. E. Mallet⁶⁹, Paolo Petta⁷⁰, etj., i janë kushtuar veprimtarisë së stratiotëve kryesisht në Itali dhe shumë më pak në

⁶³ Standen to A. Bacon: "The letter that goeth herewith to Lord Willoughby is from Captain Giergio Cesis, an Albanoy and a tall soldier, who in time of the late Duke of Parma commanded a company of light horse in the Low Countries; he writeth to the Baron about a passport of my Lord Admiral for himself and servants to pass by sea to Spain, whither he goeth to pretend recompence of the King, and from thence to Italy to serve the Duke of Tuscany. The French King's passport he hath already", Calais, 20 qershor 1593. *Calendar of the Cecil Papers in Hatfield House*, vol. 4, 1892, f. 327-334.

⁶⁴ "I veneziani, in tutte le città della Mora che sono sotto il loro dominio soldo molti albanesi a cavallo... Questa gente è per natura molto rapace, e più atta alle correrie che alle battaglie. Usano targa, spade e lancia... Più valorosi di tutti gli altri son quei di Napoli".[Nafplio]. Coriolano Cippico, *Della guerre de' Veneziani nell' Asia dal 1470 al 1473*, Venezia: 1796, f. 10.

⁶⁵ Marino Sanuto, *La spedizione di Carlo VIII in Italia*, ed. R. Fulin Venezia: 1883, f. 313-314; Marino Sanuto, *Commentarii della guerra di Ferrara*, Venezia: 1829, f. 115: "Gli stratiote sono gente chiamata latinamente epiroti, turchi, greci, albanesi, di grande coraggio, apparecchiati ad ogni pericolo ... A Napoli di Romania, e nei lughj vicini della Grecia e Morea, sotto la Signoria nostra vene sonno infiniti."

⁶⁶ Philippe de Comines, *Memoires*, vol.2, London, Paris: 1747, f. 27-28; *The Memoirs of Philip de Commines, Lord of Argenton: Containing the Histories of Louis XI and Chales VIII, Kings of France, and of Charles the Bold, Duke of Burgundy*, ed. Andrew R. Scoble, vol. 2, London: 1856, f. 200-201.

⁶⁷ F. L. Taylor, *The Art of War in Italy, 1494-1529*, London: Cambridge University Press, 1921, f. 72-73.

⁶⁸ Konstantinos Sathas, *Hellenes stratiotai en tei dysei kai he anagenesis tes hellenikes taktikes*, Athens: 1885.

⁶⁹ M. E. Mallet and J. R. Hale, *The Military organization of a Renaissance State: Venice ca. 1400 to 1617*, London: Cambridge University Press, 1984.

⁷⁰ P. Petta, *Stratioti: soldati albanesi ...*

Europë. Disa nga studiuesit autoritarë mendojnë madje se nëpërmjet tyre u rigjallëruan taktikat ushtarake të kalorësisë së lehtë në Europë⁷¹.

Interesant është fakti se kur flitej për vlerat dhe aftësinë e kësaj kalorësie të lehtë shqiptare, ata jo vetëm krahasoheshin me modele më të afërta ushtarake siç ishin jinetët spanjollë, por madje nuk mungonin edhe vëzhgues që i krahasonin me tradita kalorësiake të një gjeografie aq të largët si ajo anglo-skoceze e Kalorësisë së Veriut. Në të vërtetë kishte një ngjashmëri ndërmjet taktikave dhe armatimit të kalorësisë së lehtë angleze me llojet e tjera bashkëkohëse të kalorësisë së lehtë, por megjithatë secila kishte edhe veçoritë e veta⁷². Kështu në tetor 1453, Sir John Wallop i pohonte perandorit Karlit V se Kalorësia angleze e Veriut mund t'ua kalonte deri edhe stratiotëve shqiptarë⁷³, megjithatë kur perandori i pa kalorësit e veriut në betejë kundër francezëve, ai i krahasoi ata me kalorësinë e lehtë magrebine. Arsyeja duket se perandori nuk kishte si duket njohuritë për të krahasuar kalorësinë angleze me atë shqiptare, prandaj i krahason ata me një shembull të cilin ai e njihte më mirë, atë të kalorësve magrebinë.

Në trajtesën e Fernández de Andrade, rreth kalorësive të lehta dhe kur ai lëvdon stratiotët dhe përshkruan përdorimin e kapeleve alashqiptarçe, ai pohon një lidhje kulturore. Sipas Irigoyen-García ka një lidhje të qartë dialektike ndërmjet stileve kalorësiake ndërmjet Spanjës dhe Shqipërisë gjatë shek. XVI që nuk është vënë re si duhet. Në perceptimin e kohës stratiotët shqiptarë shpesh përshkruhen si “turq” për shkak të mënyrës dhe taktikës së luftimit, por edhe për shkak të veshjes së tyre.⁷⁴ Megjithatë duhet pasur parasysh se ky identifikim mbështetet më tepër në mosinformimin e duhur të vëzhguesve apo përshkruësve në fjalë. Interesant është fakti që një mvëshje e tillë orientale u jepej edhe kalorësve të veriut të Anglisë nga perandori Karli V. Megjithatë në traktatin e Diego de Salazar “Tratado de re military” më 1536, stratiotët

⁷¹ Brian M. Downing, *The Military Revolution and Political Change: Origins of Democracy and Autocracy in Early Modern Europe*, Princeton University Press, 1992, f. 66.

⁷² J. M. Becker, *Armed conflict and border society ...*, f. 36.

⁷³ *Letters and Papers, Foreign and Domestic ...*, XVIII (2), no. 291.

⁷⁴ Irigoyen-García, “The Game of Canes...”, f. 242; P. Petta, *Stratioti: soldati albanesi ...*, f. 25-29, 44-54.

dhe jinetët përshkruhen si dy stile të ndryshme por plotësuese të kalorësisë së lehtë⁷⁵.

Ky perceptim i “orientalizuar” i mënyrës së luftimit stratiot ishte më i theksuar në dëshmitarët nga vendet e Europës Veriore, për të cilët edhe kalorësia e lehtë spanjolle e kohës “jinetas”, perceptohej si maure apo magrebine. Madje për autorin francez Philippe de Comines stratiotët shqiptarë dhe “jinetas” spanjollë ishin pak a shumë e njëjta gjë⁷⁶. Nga ana tjetër vëzhgues më të njohur me realitetin mesdhetar siç është rasti i spanjollit Fernandez de Andrade, i perceptojnë kalorësinë e lehtë spanjolle e shqiptare, apo jinetas e stratiotë, jo si magrebinë e turq, por si dy popuj europianë nga dy skajet e Mesdheut, të cilët për shkak të sinkretizmit kulturor që pasqyrojnë perceptoheshin si orientalë nga vëzhguesit e largët.⁷⁷

Studimi i emrave të stratiotëve që dalin nëpër dokumentet nga më të ndryshmet i bërë nga K. Mbires del në përfundimin se rreth 80% e emrave të stratiotëve janë të origjinës shqiptare dhe vetëm 20 % grekë, kryesisht ato të oficerëve.⁷⁸

Ndodhte jo rrallë që përveç vlerësimeve të merituaru u visheshin edhe veti apo sjellje të ndikuara nga ndryshimi kulturor apo edhe faktorë të tjerë. Në disa raste zyrtarët venedikas i akuzonin si "antikristianë, tinzarë, hajdutë të lindur e tradhtarë mundshëm". Të gjitha këto i shpjegon fakti që ata konsideroheshin nga ndonjë zyrtar si aq të pabindur apo më saktë të pavarur sa që nuk i kishin sjellë asnjë dobi Sinjorisë.⁷⁹ Vlerësime të tilla natyrisht ishin subjektive dhe këtë e tregon rasti i betejës së Fornovos ku në fakt aty e krijuan përshtypjen dhe famën e mirë që i shoqëroi gjatë dy shekujve pasues. Megjithatë nuk munguan ata që i

⁷⁵ Salazar thekson se janë të domosdoshme për çdo betejë “los caballos ligeros de lanzas estratiotas y jinetas”. *Tratado de re militari*, ed. Eva Botella Ordinas, Madrid: Ministerio de Defensa, 2000, f. 170.

⁷⁶ Philippe de Comines i përngjason si me spanjollët ashtu edhe me turqit: “Stratiotz sont gens comme genetaires, vestuz, a pied et a cheval comme les Turcs, sauf la teste, ou ilz ne portent ceste toile qu’ilz appellant tolibam”. Philippe de Comines, *Mémoires (1524)*, 2 vols. ed. Joel Blanchard, Geneva: Droz, 2007, vol. 1, f. 625.

⁷⁷ Irigoyen-García, “The Game of Canes...”, f. 243.

⁷⁸ Kostas Mpirts, *Oi Arvanites, oi Dorieis tou neoterou Hellenismou*, Athinë: 1960, pp. 191-192.

⁷⁹ M. Mallet and R. Hale, *The Military organization of a Renaissance State ...*, f. 376-377.

kritikuan se kishin sulmuar më shumë për të plaçkitur francezët se sa për t'i mundur.⁸⁰

S u m m a r y

THE ROLE AND PRESENCE OF THE ALBANIAN LIGHT CAVALRY IN NORTHERN EUROPE IN THE 16TH CENTURY

Evidences on the presence and role of Albanians in northern European countries, especially the Netherlands and England can be traced from the fourteenth and fifteenth centuries. Especially during the fifteenth century the Albanians are documented as sailors and rowers, mostly on board of Venetian ships.

In the sixteenth century the Albanian presence in Northern Europe will continue to be important, but now not as sailors and rowers, but primarily as combatants, or stratiotes. Although the stratiotes are mentioned since the beginning of the fifteenth century in Greece, their involvement in Italy begins in the late fifteenth century. It can be said that the golden century of presence and importance of stratiotes as well as the culmination of their geographical presence was in the sixteenth century. Their commitment was important not only during conflicts, but also as peacekeepers in peacetime. Despite the fact that in the sixteenth century they can be found in the farthest corners of Europe, from Italy and Spain to the distant Scotland, the gate of entry into Europe was undoubtedly through Italy, especially Venice and the Spanish possessions of Southern Italy.

⁸⁰ John S. C. Bridge, *A History of France from the Death of Louis XI*, vol. 2, Oxford University Press, 1924, f. 263.

